



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LKARSKA KOMORA KOSOVA

## Oda e Mjekëve të Kosovës



Raport i Punës për tremujorin e parë

Janar-Mars, 2024

Prishtinë, Prill 2024

Ky raport paraqet punën e OMK-së për periudhën Janar-Mars të vitit 2024.

Raporti përmbledhë aktivitetet e të gjitha njësive organizative të OMK-së, duke u koncentruar në fushat kryesore, të cilat përbëjnë objektivat e punës së Odës.

## Përmbajtja:

1. Përmbledhje ekzekutive.....	4
2. Këshilli Drejtues.....	5
3. Anëtarësimi .....	6
4. Mbikëqyrja etiko-profesionale .....	7
5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional .....	8
6. Licencimet.....	8
7. Këshilli Mbikëqyrës .....	9
8. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së .....	9
9. Komisioni për Edukim Specialistik.....	9
10. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke.....	9
11. Raporti financiar.....	10
11.1. Raporti financiar për periudhën Janar - Mars 2024 .....	10
11.2. Prokurimi.....	11
12. Aktivitete të tjera .....	11
12.1 Revsita Mjeku – Trakti tretës .....	11
12.2 Marrëveshja për Delegimin e Fondeve dhe Implementim.....	12
12.3Marrëdhëniet ndërkombëtare.....	12
12.4Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike.....	13
13. Plani i veprimit për 2024 .....	14

## **1. Përmbledhje ekzekutive**

Gjatë këtij tremujori, u mbajt 1 mbledhje nga kuvendi i OMK-së.

Me datë 20 shkurt 2024 u mbajt mbledhja e 5 e legjislaturës së tretë të Kuvendit të OMK-së. Në këtë mbledhje u shqyrtuan dhe u aprovuan:

- Rregullorja për sistemin e kompensimeve të të zgjedhurve të organeve të Odës;
- Rregullorja për sistemin e pagave dhe kompensimeve të tjera të zyrtarëve të shërbimit profesional të Odës së Mjekëve të Kosovës;
- Plotësim/Ndryshimi i Rregullores për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional;
- Draft/Projekt Buxheti i vitit 2024;


## 2. Këshilli Drejtues

Këshilli Drejtues i OMK-së ka mbajtur tri (3) takime, lëndët e shqyrtuara janë si më poshtë:


Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën janar-mars	Vendimet/Përgjigjet sipas kërkesave/ ankesave të pranuar për periudhën janar-mars	Vendimet në procedurë	Vendimet e Këshillit Drejtues për periudhën janar - mars	Vendime/Pergjigje për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Këshilli Drejtues i Odës	9	12	0	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vendim për aprovim të Draft-Rregullores për sistemin e pagave dhe kompenzimeve të shërbimit profesional;</li> <li>- Vendim për aprovim të Draft-Rregullores për sistemin e pagave dhe kompenzimeve të zgjedhurve të Odës;</li> <li>- Vendim për aprovim të propozimeve të Komisionit për Rregulloren e EVP</li> <li>- Vendim për miratimin e Draft buxhetit për vitin 2024</li> <li>- Vendim për emerim të anetareve të redaksisë së Revistes Mjeku</li> </ul>	0

### 3. Anëtarësimi

Në Odën e Mjekëve të Kosovës u anëtarësuan 101 mjekë, nga të cilët 6 mjekë të punësuar në sektorin publik, 6 mjekë të punësuar në sektorin privat, 89 mjekë të papunë.



Grafikoni 1. Anëtarësimet për periudhën kohore Janar – Mars 2024



Grafikoni 2: Totali i përgjithshëm i anëtarëve deri më datën 31 Mars 2024

Gjatë kësaj periudhe janë ndarë nga jeta 7 mjekë si dhe janë rianëtarësuar 17 mjekë, si rezultat numri total i anëtarëve deri me datën 31 Mars është 5398 mjekë.


#### 4. Mbikëqyrja etiko-profesionale

Për ta pasqyruar ecurinë e mbikëqyrjes etike dhe profesionale pranë organeve të Odës, në mënyrë tabelare do të paraqesim ushtrimin e funksionit të tillë nga ana e organeve të odës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuarra për periudhën janar– mars	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për periudhën janar– mars	Sanksionet e shqiptuarapër periudhën janar– mars	Sanksionet e ekzekutuara për periudhën janar– mars	Lëndët e bartura nga periudhat paraprake	Lëndët në shqyrtim
Prokurori i Odës	21	16	N/A	N/A	14	19
Këshilli Etik	17	19	Rekomandim kolegjale 1 Qortim Publik 1	Rekomandim kolegjial 1 Qortim Publik 1	16	14
Gjyqi i Nderit	1	1	///	///	0	0
Certifikatate të kaluarës etike	209	///	///	///	///	///


## 5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional

Komisioni për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional ka akredituar gjithësej 38 aktivitete. Në kuadër të aktiviteteve të akredituara, 5 prej këtyre akreditimeve janë me taksë administrative.



## 6. Licencimet

Komisioni për Licencim dhe Rilicencim profesional ka lëshuar gjithësej 285 licenca me kategoritë si në grafikun e mëposhtëm:





## **7. Këshilli Mbikëqyrës**

Këshilli Mbikëqyrës i OMK-së ka mbajtur 5 takime ku i kanë shqyrtuar Vendimet e Këshillit Drejtues, Këshillit Etik dhe të organeve të tjera të OMK-së.

## **8. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së**

Komisioni për Çështje Etike i OMK-së ka pranuar gjithsejt tetëmbëdhjetë 18 kërkesa, ku janë nxjerrë 16 vendime aprovuese, 1 Vendim refuzues për kthim raporti dhe 1 lëndë është kthyer për plotësim lënde.

## **9. Komisioni për Edukim Specialistik**

Komisioni për Edukim Specialistik ka mbajtur 1 takim.

## **10. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke**

Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së ka pranuar gjithsej 12 kërkesa., ku janë nxjerrë 8 vendime aprovuese dhe 4 lëndë janë kthyer për plotësim lënde.

Poashtu, Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së, në periudhën TM1 ka nxjerrë vendim për caktimin dhe llogaritjen e shumës për ndarjen e ndihmës solidare, me qëllim për të qenë sa më objektiv dhe të drejtë gjatë trajtimit të kërkesave të palëve.

## 11. Raporti financiar

### 11.1. Raporti financiar për periudhën Janar - Mars 2024

1.0 Të hyrat:		
1.1 Paraja në bankë me 31.12.2023	€	825,695
<b>Total Paraja në bankë me 31.12.2023</b>	<b>€</b>	<b>825,695</b>
1.2 Të hyrat	Realizimi: TM1	TOTAL
1.2.1 Të hyrat nga anëtarësia:		
1.2.2 Anëtarësimi i mjekëve shtetas kosovarë	€	355,325
1.2.3 Anëtarësimi i mjekëve shtetas jo kosovarë	€	3,450
1.2.2 Licencimi	€	14,215
1.2.3 Të hyrat e tjera*	€	9,858
<b>Të hyrat deri me 31.03.2024</b>	<b>€</b>	<b>382,848</b>
<b>Paraja në bankë me 31.12.2023</b>	<b>€</b>	<b>825,695</b>
<b>TOTAL TË HYRAT</b>	<b>€</b>	<b>1,208,543</b>
2.0 SHPENZIMET	Shpenzimet: TM1	TOTAL
2.1 Paga, meditje dhe kontributet pensionale	€	67,031
2.2 Material shpenzues	€	814
2.3 Reprerentacioni	€	1,345
2.4 Edukimi i vazhdueshëm profesional	€	33,660
2.5 Shpenzimet e tjera*	€	8,570
2.6 Shpenzimet e asetëve	€	390
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	€	1,750
<b>TOTAL SHPENZIMET 31.03.2024</b>	<b>€</b>	<b>113,561</b>
<b>Neto të hyrat për TM 1 2024</b>	<b>€</b>	<b>269,287</b>
<b>TOTAL BILANCI 31.03.2024</b>	<b>€</b>	<b>1,094,982</b>

Faksimili, Faksimili i dytë, Certifikata për të kaluarën etike profesionale, Taksa për paraqitjen e provimit, Kongreset, simpoziumet, seminarët, Lejimi për hulumtime për persona juridik, Të ardhurat nga interesi BKT, Dhurata / donacione, Të ardhurat të tjera.

2.5\*Faksimili, Shpenzimet për botimin e revistës, Organizimi i mbledhjeve të kuvendit, Shpenzimet e ID kartelave të Odë, Shpenzime të përkthimeve/lektorimit, Meditje për udhëtime zyrtare, Trajnime për stafin, Mirembajtja e softverit për financa, Shpenzimet e tel, Shpenzimet e int., Shpenzimet e postës, Pajisje të IT, Shpenzime bankare, Shpenzimet e pastrimit, Shpenzimet e transportit, Shpenzimet e tjera operative.

## 11.2. Prokurimi

Në muajin shkurt u zhvillua 1 procedurë e hapur e prokurimit për shërbimet e përkthimit dhe lekturimit të dokumentëve të OMK-së. Procedura e prokurimit u zhvillua me sukses dhe brenda afatit u lidh kontrata me operatorin ekonomik.

## 12. Aktivitete të tjera

### 12.1 Tryeza e rumbullakët mes OPOH-ve dhe grupin punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor

Kryetarët e OPOH-ve mbajtën tryezë të rumbullakët me komisionin Parlamentar për Shëndetësi të Kuvendit të Republikës të Kosovës përkatësisht grupin punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor.

Qëllimi i kësaj tryeze ishte monitorimi i zbatimit të ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë dhe rrjedhimisht u diskutua për ligjin e OPOH-ve dhe kompetencat e odave, sfidat më të rëndësishme me të cilat po përballen odat në zbatimin e ligjit dhe si janë adresuar këto sfida, koordinimi mes Ministrisë së Shëndetësisë me Odën e Mjekëve, për zbatimin e legjislacionit si dhe a ka pasur ndonjë kërkesë apo iniciativë për plotësim dhe ndryshim të Ligjit.

Tryeza e rumbullakët përfundoi me një konsensus mbi domosdoshmërinë e organizimit të tryezave dhe takimeve të përbashkëta dhe bashkëpunimit gjatë muajve në vazhdim ndërmjet Odës së Mjekëve të Kosovës dhe grupit punues.

### 12.2 Revista Mjeku – Trakti tretës

Vëllimi 4, Numri 1 i Revista Mjeku, ka temë bosht Trakti tretës, e cila u publikua gjatë muajit mars 2024.

Ky numër përbëhet gjithsej nga 25 artikujve, ku trajtohen tema rreth kësaj lëmie duke përfshirë edhe portretin e një mjekut dhe Këshillat Juridike.

Revista është publikuar në Web-faqen e OMK-së si dhe faqe zyrtare të facebookut.

Gjeni të bashkangjitur mëposhtë linkun e publikimit të këtij numri:

<https://omk-rks.org/revista-mjeku/>

### **12.3 Marrëveshja për Delegimin e Fondeve dhe Implementim**

Oda e Mjekëve të Kosovës dhe projekti i Luxembourg Development KSV/017, në vitin 2022 kanë nënshkruar marrëveshje për delegimin e fondeve dhe implementimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me ndërtimin e kapaciteteve të stafit mjekësor të Spitaleve të Përgjithshme të Gjilanit dhe Prizrenit.

Marrëveshja ka të bëjë me zbatimin e aktiviteteve të programit për trajnimin dhe zhvillimin profesional të mjekëve të spitaleve përkatëse. Program i cili është hartuar mbi planin e menaxhimit të burimeve njerëzore për periudhën 2022-2026 dhe përmes këtyre trajnimeve mjekët e këtyre spitaleve do të kenë mundësi të ngritin shkathtësitë dhe njohuritë e tyre në aspektin profesional.

Në kuadër të kësaj marrëveshje janë organizuar dhe përkrahur financiarisht trajnimet si më poshtë:

- Kardiologji intervente;
- Kardiologji në Spitalin e Përgjithshëm të Celjes, Slloveni;
- Organizimi i ambulantes për elektrokonzervim në Spitalin e Përgjithshëm të Celjes, Slloveni;
- Radiologji intervente - endovaskulare/neurovaskulare në bazë të Planit Nacional për Stroke 2022-2025, në Spitalin Univsitar Aydin në Stamboll, Turqi.

### **12.4 Njohja e kualifikimeve Profesionale-Kriter për Anëtarësimin e Kosovës në BE**

Oda e Mjekëve të Kosovës, një nga akteret kontributdhënës për njohjen e kualifikimeve profesionale, e qe është njëra nga kriterët për anëtarësimin e Kosovës në BE. Në këto aktivitete ODA perfaqësohet nga Zyra Ligjore e OMK-së, e që për qëllim është rregullimi i profesioneve sektoriale si: Mjek, Dentist, Infermier, Mami, Farmacist, Veteriner dhe Arkitekt. Si rezultat i këtij aktiviteti, MASHT do të krijoj grupin punues për draftimin e Ligjit për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale.

## 12.5 Marrëdhëniet ndërkombëtare

### Mbledhja e Komitetit të Përhershëm Evropian të Mjekëve (CPME)

Komiteti i Përhershëm Evropian i Mjekëve (CPME) në muajin mars mbajti punimet e rregullta 6 mujore. Takimi i rradhës është mbajtur në Ljublanë, ku përfaqësuesi i Odës së Mjekëve të Kosovës morri pjesë në punimet e takimit të radhës së Komitetit të Përhershëm Evropian të Mjekëve (CPME).

Nikoqiri i këtij takimi ishte Oda e Mjekëve të Sllovenisë. Tema diskutimi gjatë mbledhjes ishte:

- Parimet, Pacientët dhe Etika
- Shëndetësia dixhitale
- Praktika profesionale dhe sistemet shëndetësore
- Shëndeti publik dhe parandalimi i sëmundjeve

Temë qendrore e takimit ishte pavarësia e profesionit mjekësor. Gjithashtu u diskutua rreth një gamë të gjerë temash në lidhje me politikat shëndetësore evropiane, duke përfshirë punën e vazhdueshme të Komitetit për reformat e politikave shëndetësore dhe ambiciet e Komitetit që gjatë mandatit të ardhshëm 2024-2029 të vazhdoj punën në themelimin e Bashkimit Shëndetësor Evropian

Gjatë takimit të gjitha odat e mjekëve nga shtetet e ndryshme prezantuan raportet kombëtare për sfidat e sistemeve shëndetësore dhe të vet profesionit të mjekëve, ku gjithashtu u raportua për gjendjen dhe sfidat e profesionit të mjekut në Kosovë.

## 12.6 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike

Në kuadër të kompetencës publike lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë profesionale të mjekëve, Kryetari i OMK-së duke u bazuar në kompetencat ligjore sipas Ligjit për OPSH-të, në bazë të kërkesave nga Këshilli Etik i OMK-së, Prokurori i OMK-së, Gjykatat Themelore ka caktuar ekspert apo grupe të ekspertëve lidhur me konstatimin e përgjegjësisë profesionale mbi zbatimin e procedurave mjekësore nga mjekët gjegjës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën janar-mars	Vendimet sipas urdhëresave/kërkesave të pranuar për periudhën janar-mars	Në procedurë	Raportet e ekspertizave të përfunduara për periudhën janar-mars	Vendime për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
<b>Kryetari i Odës</b>	5	5	6	2	0

### **13. Plani i veprimit për 2024**

#### **Projektet/Planet 2024**

- Vazhdimi i realizimit të Projektit për ndërtimin e objektit për të gjitha OPSH-të, financiar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja për sektorin e shëndetësisë” dhe OPSH-të. Në këtë fazë sipas procedurave administrative dhe hapave të planifikuar deri në përfundim të projektit, kemi pranuar lejën për kushtet ndërtimore nga komuna e Prishtinës. Hapi i ardhshëm i projektit është që të bëhet plani detal i objektit nga arkitektët, si rezultat OPSH-të së bashku me projektin Luxembourg Development të bëjnë hapjen e tenderit për fillimin e punimeve.
- Lansimi i Platformës digjitale për menaxhimin e profesionistëve shëndetësorë, ku do të përfshihen të gjitha proceset dhe shërbimet e OMK-së. Staf i profesional janë në fazën e mbajtjes së trajnimeve dhe testeve përfundimtare të përdorimit të platformës. Ndërsa gjatë tremujorit të dytë do realizohen video informuese dhe trajnime për anëtarët e OMK-së për përdorim të platformës, ku gjithashtu planifikohet të fillojë përdorimi i platformës nga të gjithë anëtarët e OMK-së.
- Organizimi i simpoziumit të përvitshëm ZEVA 2024.
- Organizimi i Kongresit të VI të Mjekësisë, me temën “Sfidat e Diagnostikës së Mijëvjeçarit”.
- Vazhdimi i zbatimit të projekteve për profilizim dhe shkollim specialistik jashtë vendit, bazuar në marrëveshjen mes OMK dhe SHSKUK.
- Vazhdimi i zbatimit të Marrëveshjes për Delegimin e Fondeve dhe Implementim projektit KSV/017-21 2749. Deri në fund të vitit janë të planifikuara të realizohen dy vizita studimore dhe tre trajnime.
- Hulumtim për vlerësimin e sindromit burnout (shpenzimi profesional i mjekëve). Qëllimi i hulumtimit është të bëhet një analizë gjithëpërfshirëse të djegies profesionale (burnout) të mjekëve në Kosovë. Ky hulumtim do të realizohet gjatë tremujorit të tretë.